REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 966/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.966/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik Remzi Sopa B.I. (N.T.P. "Rexha Com") – Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.N.P. "Wenda"- Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i infrastrukturës (rrethojave, parkingjeve ne shkolla), me nr. të prokurimit: 613-20-5873-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Remzi Sopa B.I. (N.T.P. "Rexha Com") – Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i infrastrukturës (rrethojave, parkingjeve ne shkolla), me nr. të prokurimit: 613-20-5873-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan.

II. <u>ANULOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i infrastrukturës (rrethojave, parkingjeve ne shkolla), me nr. të prokurimit: 613-20-5873-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan, dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues Remzi Sopa B.I. (N.T.P. "Rexha Com") – Lipjan, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues Remzi Sopa B.I. (N.T.P. "Rexha Com") – Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.11.2020 me nr. 966/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i infrastrukturës (rrethojave, parkingjeve ne shkolla), me nr. të prokurimit: 613-20-5873-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 108/A Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar me Nr. 04/L-237, Ligji Nr. 05/L-068, Nr. 05/L092 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 25.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se jemi eliminuar për arsye se gjeodeti nuk i plotëson te gjitha kushtet, por kjo është e pa baze për arsye se një gjeodet qe te licencohet duhet se paku te këtë 3 vite përvojë pune, e gjeodetja ne listën tone është e licencuar te cilën e keni te ngarkuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, po citoj: **Kërkesa 2**: Stafin profesional Një inxhinier master apo bachelor i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv diploma CV-ja, minimum 5 vite provoj pune pas diplomimit. Një gjeodet i licencuar me se paku 3 vite përvoje pune ne profesion Licenca, diploma CV-ja, Minimumi 6 punëtor. **Dëshmia 2:** Lista e stafit duhet te dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE qe duhet te përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozicioni. a).Vendimi apo deklarata për emërimin e menaxherit te projektit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. te dëshmohen me CV, Diplomat etj, për piken, Gjeodeti te dëshmohet me CV, Diplome dhe Licence për matje gjeodezike me afat, Për te gjithë stafin duke përfshirë edhe punëtoret kontratat e punës ose para kontrata për këtë projekt. OE ankues ne platformën elektronike e-prokurim ne ofertën e tij ka ngarkuar Diplomën e noterizuar te noteri me date 02.06.2017 – LRP. Nr. rendor: 4112/2017 për znj. Selvete Liman Gagica – Bachelor i Gjeodezisë, lëshuar me date 10 Korrik 2014 me nr. 912, Licenca për kryerjen e matjeve kadastrale me nr. 165, me date te dhënies se licencës: 15.02.2017 dhe afat te skadimit: 13.02.2022 noterizuar te noteri me datë: 04.04.2018 – LRP. Nr. rendor: 1865/2018, Para kontrata për pune specifike – nënshkruar nga te dy palët për këtë aktivitet te prokurimit, kurse ne CV e prezantuar eksperienca/përvoja e punese nga Shkurt 2011 – Aktualisht është prezantuar pozita e punës: Menaxher e zyrës (DËH-KOSOVA shpk) – Prishtinë, puna me pale shitje – certifikim dhe kontabilitet, d.m.th. sipas kësaj CV për znj. Selvete Liman Gagica, nuk ka prezantuar asnjë ditë përvojë pune pas diplomimit ne fushën e gjeodezisë dhe nuk përmbush kërkesën e FDT-së si me lartë 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne profesion, prandaj bazuar ne **nenin 39 të RrUOPP-së** varësisht nga rasti i paraqitur:

Problemi	**Si te veprohet?**	**Neni i LPP-se**
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtutjeshëm	Neni 69

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne platformën elektronike e-prokurim dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të refuzohet si e

pabazuar, dhe rekomandon të mbetet ne fuqi vendimi - B58-njoftimit mbi vendimin AK (rekomandimi për dhënie të kontratës).

Autoriteti Kontraktues, me datë: 25.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Remzi Sopa B.I. (N.T.P. "Rexha Com") – Lipjan, se jemi eliminuar për arsye se gjeodeti nuk i plotëson te gjitha kushtet, por kjo është e pa baze për arsye se një gjeodet që të licencohet duhet së paku të këtë 3 vite përvojë pune, e gjeodetja në listën tonë është e licencuar te cilën e keni te ngarkuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor sqaron se AK tek kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, po citoj: **Kërkesa 2**: Stafin profesional Një inxhinier master apo bachelor i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv diploma CV-ja, minimum 5 vite provoj pune pas diplomimit. Një gjeodet i licencuar me se paku 3 vite përvoje pune ne profesion Licenca, diploma CV-ja, Minimumi 6 punëtor. **Dëshmia 2:** Lista e stafit duhet te dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE qe duhet te përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozicioni. a).Vendimi apo deklarata për emërimin e menaxherit te projektit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. te dëshmohen me CV, Diplomat etj, për piken, Gjeodeti te dëshmohet me CV, Diplome dhe Licence për matje gjeodezike me afat, Për te gjithë stafin duke përfshirë edhe punëtoret kontratat e punës ose para kontrata për këtë projekt. OE ankues ne platformën elektronike e-prokurim ne ofertën e tij ka ngarkuar Diplomën e noterizuar te noteri me date 02.06.2017 – LRP. Nr. rendor: 4112/2017 për znj. Selvete Liman Gagica – Bachelor i Gjeodezisë, lëshuar me date 10 Korrik 2014 me nr. 912, Licenca për kryerjen e matjeve kadastrale me nr. 165, me date te dhënies se licencës: 15.02.2017 dhe afat te skadimit: 13.02.2022 noterizuar te noteri me datë: 04.04.2018 – LRP. Nr. rendor: 1865/2018, etj.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 9.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me gjeodeten, dhe pastaj të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK Lipjan;

1x1 OE Remzi Sopa B.I. (N.T.P. "Rexha Com");

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.